



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.60, datë 02.04.2024

PËR
“SHQYRTIMIN E KËRKESAVE PËR LEJE ZHVILLIMI/NDËRTIMI NGA
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT, MBI ZHVILLIMET QË SHTRIHEN NË
DISA NJËSI STRUKTURE”

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 26 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr.408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:


1. Në bashkitë të cilat kanë Plane të Përgjithshme Vendore në fuqi, për lejet e zhvillimit dhe ndërtimit në kompetencë të Këshillit Kombëtar të Territorit, Sekretariati i KKT-së, mund të vijojë me shqyrtimin e projekt-propozimeve, gjurma e të cilave shtrihet në dy ose më shumë njësi strukturore si (UB), (N), (B), vetëm nëse gjurma e projektit ka mbi 50% të sipërfaqes në njësinë strukturore që lejon zhvillimin dhe plotësohen kushtet e pikës 2 të këtij vendimi.
2. Sekretariati teknik i KKT-së të vijojnë me shqyrtimin e aplikimeve për leje zhvillimi dhe leje ndërtimi sipas pikës 1 të këtij vendimi, pas:
 - a) Marrjes së kofirmimit nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për përfshirjen e parcelave nga sistemi bujqësor në sistemin urban, me përjashtim të llojit të resursit të tokave të pafrytshme;
 - b) Marrjes së kofirmimit nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për përfshirjen e parcelave nga sistemi natyror në sistemin urban për llojin e resursit pyll, kullotë dhe livadh;
3. Institucionet shtetërore sipas pikës 2 të këtij vendimi kanë detyrimin që brenda 10 ditëve pune

ILLI I MINIST.

nga kërkesa t'i njoftojnë Sekretariatit teknik të KKT-së, në rrugë elektronike, aktet e pëlqimit / konfirmimit lidhur me zhvillimin e propozuar. Në mungesë të përgjigjes brenda afatit 10-ditor, pëlqimi/konfirmimi konsiderohet i dhënë dhe Sekretariati teknik i KKT-së ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për leje zhvillimi apo ndërtimi.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit të integrojnë parashikimeve të këtij vendimi në dokumentat e planit të përgjithshëm vendor, gjatë hartimit ose rishikimit të tij, duke ndjekur përcaktimet e vendimit nr.686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", të ndryshuar.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Agjencia e Zhvillimit të Territorit, autoritetet vendore të zhvillimit të territorit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.
6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 10/05 2024